REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TE ARDHURAVE LEJEVE LICENSAVE DHE BORXHIT

PAKETA FISKALE
2026

Nentor , 2026

Bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ i ndryshuar, ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetqeverisjen vendore ” i ndryshuar, Ligji Nr.9723 datë 03.05.2007 “ Për regjistrimin e biznesit ”,I ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “ Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, V.K.M Nr.132 datë 07.03.2018 “ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa,bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës ” i ndryshuar. Ligji Nr.29/2023 “ Për Tatimin mbi të ardhurat “ I ndryshuar, Ligji Nr.10081 datë 23.02.2009 “ Për licencat,autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar. Ligji Nr.9975 datë 28.07.2008 “ Për Taksat Kombëtare ” i ndryshuar. Ligji Nr.20/2020 “ Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ” i ndryshuar**.** Ligji Nr.10465 datë 29.09.2011 “ Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë ”, i ndryshuar**,** Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 “ Për kundravajtjet administrative ” Ligji Nr.57/2025 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ”**.** V.K.M. Nr.179 datë 09.03.2016 “ Për miratimin e statutit të Qëndres kombëtare të Regjistrimit ”. V.K.M Nr.783 datë 10.11.2011 “ Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore ” i ndryshuar,V.K.M Nr.54 datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kritereve,dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shteterore ” i ndryshuar**.**V.K.M Nr.559 datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytezim, përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike , dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre I ndryshuar. V.K.M Nr.607 datë 29.07.2020 “ Për tarifat e për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi I mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi I ndryshuar ” Ligjit Nr.68/2017 datë 27.04.2017 “ Për financat e vetqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Ligjin Nr.152/2015 datë 21.12.2015 “ Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ” Ligji Nr.24/2017 “ Për administrimin e Ujitjes dhe Kullimit” VKM Nr.319 datë 31.05.2018 “ Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve ”.

Përmbajtja

Taksat vendore

1. TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

1.1 TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

- Taksë mbi Ndërtesat
- Taksë mbi Tokën Bujqësore
- Taksa mbi Truallin

3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

4. TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE MBI PASURITE E PALUAJTSHME

5. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

6. TAKSA E REGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE

7. TAKSA E TABELES DHE REKLAMES

8. TAKSA PER DHENIEN E LICENSAVE PER TREGETIMIN ME PAKICE TE KARBURANT

9. TE ARDHURA NGA TE TRETE.

Tarifat vendore

1. **TARIFA E PASTRIMIT**
2. **TARIFE NDRICIMI**
3. **TARIFE GJELBERIMI**
4. **TARIFË PËR MIRËMBATJEN E KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA**
5. **TARIFA E ZENIES SE HAPESIRES PUBLIKE**
6. **TARIFE PER CERTIFIKATAT DHE LEJAT E TRANSPORTIT**
7. **TARIFE LEJE (NON STOP)**
8. **TARIFE PARKIMI**
9. **TARIFE PER SHERBIM VARIMI**
10. **TARIFA TE NDRYSHME BASHKIE**
11. **TARIFE PER QERA TRUALLI**
12. **TARIFE CERDHE**
13. **LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE TE BASHKISE DEVOLL**
14. **TARIFAT PER SHITJE TE PRODUKTEVE BUJQESORE DHE TARIFA PER SHERBIMIN E UJITJES**
15. **MASA E DEBISE NGA TAKSAT DHE TARIFAT FAMILJARE DHE ATO TE BIZNESIT**

TAKSAT VENDORE

1. Taksa e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin

Çdo subjekt,i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabarte me 8.000.000 (*tetë milion*) lekë i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, por për vitin 2024 me vendim Qeverie me akt normative Nr 19 datë 23.04.2020 u perjashtuan të gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore deri në *14.000.000 (katërmbëdhjetë million) lekë* në lidhje me tatim fitimin.

Baza e takses/tatimit; Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin,për vitin vijues,për tatim paguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milion lekë llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si në tabelën e mëposhtme;

Taksa e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin lekë/vit **Tabela Nr 1**

Nr	Qarkullimi vjetor i biznesit	Niveli i Takses	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Me qarkullimvjetor nga 0 – 2.000.000lekë	0	0
2.	Me qarkullim vjetor nga 2.000.001 – 10.000.000 lekë	0	0
3.	Me qarkullim vjetor mbi 14.000.000 leke	15% e fitimit	15% e fitimit
	TOTALI		

Mënyra e pagesës: Tatim paguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të biznesit të vogel Brënda datës 20 Prill për tremujorin e parë, brënda datës 20 Korrik për tremujorin e dytë, brënda datës 20 tetor për tremujorin e tretë dhe brënda datës 20 Dhjetor për tremujorin e katër.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore në rolin e agjentit tatimor është e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse dhe kalimin e saj për llogari të buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Për këtë shërbim D.R.T Korcë përfiton 1 % të të ardhurave nga ky zë.

Të ardhurat e parashikuara nga kjo taksë: Për vitin 2026 nga realizimi për 9 mujorin e parë të vitit 2025 bazuar në shkresë Nr 8806/2 datë 14.10.2025 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korcë, parashikimi i kësaj Takse për arkëtim për vitin 2026 do të jetë në nivelin prej 120.000 Lek .

TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

Në zbatim të gërmës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore" njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfituese të 2 % nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP) që realizohen në juridiksjonin e tyre. Për vitin 2025 Tatimi mbi të Ardhurat Personale u shpërnda në bazë të numrit të popullsisë së Bashkive për arsye se nuk është gjetur akoma mekanizimi i duhur teknik sipas juridiksjonit të punonjësve ku mblidhet tatimi. Për efekte të përllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të merren si të ardhura të tatueshme, të ardhurat e përcaktuara në nenin 8 të ligjit nr 8438 datë 28.12.1998. Bazuar dhe në shkresë e Ministria e Finacave Nr.13732/1 datë 30.09.2025."Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP) **Tabela Nr 2**

Nr.	Emërtimi i Taksës	Niveli i Taksës		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	*Nj.e Tjera*		
1.	Tatimi mbi të Ardhurat Personale				
	TOTALI				

2.TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vëndas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavaresisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimi për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka sipas rastit pronari ose bashkëpuntori sipas pjeses që zotëron apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Taksat llogariten si detyrim vjetor I taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet ,tjetersohet ose zhduket brenda kësaj periudhe detyrimi I taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhen e së drejtës së pronësisë. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

1. **Taksa mbi ndërtesën**
2. **Taksa mbi tokën bujqësore**
3. **Taksa mbi truallin**

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vleresojë sipërfaqen e taksueshme.

➢ Taksë mbi ndërtesat

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:
a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
ç) banesat sociale në pronësi të bashkive; d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 106/2013, datë 28.3.2013. Botuar ne Fl. Z. nr. 53, datë 15 prill 2013).
(Ndryshuar me Ligj Nr. 142/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.252, datë 22.01.2016)
(Ndryshuar me Ligj Nr. 106/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.222, datë 19.12.2017)
Ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, datë 03.12.2018, botuar në F.Z. nr.187, dt.27.12.2018

Përkufizime:

"Çmimi vlerësues", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

"Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

"Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

"Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

"Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

"Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

"Përdorues", individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

"Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

"Vlerë e pasurisë", Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

"Veprimtari ekonomike", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

➢ Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Devoll është **40 200 lekë/m² për qytetin Bilisht (ZK.1187), ndërsa në Njësitë Administraive çimimi është 35 000lekë/m^2 (sipas VKM 132/2018 dhe urdhërit Nr.1052 datë 02.12.2024 "Për miratimin e mesatares së çmimeve tëshitjes të banesave në treg" .**

➢ Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim janë si më poshtë vijon:

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe proçese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.
4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
6. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.
7. Për ndërtesat e privatizuara me Ligjin Nr. 7652, datë 23.12.1992, " Për privatizimin e banesave shtetërore ", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) përqind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së pare.

<u>Shkalla e taksës mbi ndërtesat:</u>

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. **(Ndryshuar me Ligj Nr. 106/2017, datë 30.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.222, datë 19.12.2017)**

c) Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "*ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim*".
- Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "*ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike*".
- Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "*ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume*".

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*", të ndryshuar.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme " ndërtesa ", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës " nenit 2 pika 3 ku thuhet: Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

1. <u>Taksa mbi ndërtesa për qëllime banimi</u>. **Tabela Nr 3**

Emërtimi	**Vlera në lekë/m sipas Ligjit 106/2017**	**% mbi shkallën e taksës**
Banesa Bilisht	<u>17.5 leke</u> (40,200 * 0.05%)	20.1 leke/m^2
Banesa Njësi Administrative	12.25 leke (35,000*0.035%)	12.25 leke /m^2

2. <u>Njësi tregëtimi dhe shërbimi.</u> **Tabela Nr 4**

Emërtimi	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	% mbi shkallën e taksës
Njësi tregëtimi dhe shërbimi	200	105 (52,500 * 0.2%)	105 lekë/m^2

3. <u>Veprimtari bujqësore dhe blegtorale.</u> **Tabela Nr 5**

Emërtimi	Vlera në lekë/m^2 sipas ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m^2 sipas ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	% mbi shkallen e takses
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale	40 lekë	21 lekë (10,500* 0.2%)	21 lekë/m^2

4. <u>Parkime të mbyllura dhe bodrume gjithashtu dhe të hapura .</u> **Tabela Nr 6**

Emërtimi	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	% mbi shkallën e taksës
Parkime të mbyllura dhe bodrume	40 lekë	49 lekë (24500*0.2%)	49 lekë/m^2
Parkime të hapura në Bashki	40 lekë	21 lekë (10,500*0.2%)	21 lekë/m^2

5. <u>Veprimtari industriale në Bashki.</u> **Tabela Nr 7**

Emërtimi	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m^2 sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	% mbi shkallën e taksës

Veprimtari Industriale	100 lekë	35 lekë (17500*0.2%)	35 lekë/m2

Taksa mbi Ndërtesat **Tabela Nr 8**

leke/m2/vit

Nr.	Kategoritë e Ndërtesave	Niveli i Taksës	
	FAMILJET	***Nj.Bilisht***	***Nj.e Tjera***
1.	Ndërtesa para vitit 1993	20.1 lek/m2	12.25 lek/m2
2.	Ndërtesa gjatë dhe pas vitit 1993	20.1 lek/m2	12.25 lek/m2
A	**TOTALI**		
	NDERTESA PER BIZNESE	***Nj.Bilisht***	***Nj.e Tjera***
1.	Ndërtesa për Tregëti dhe Sherbime	105 lek/m2	105 lek/m2
2.	Ndërtesa për veprimtari industriale	35 lek/m2	35 lek/m2
3.	Ndërtesa për veprimtari dhe bujqësi blegtori,magazine (Frigorifere) .	21 lek/m2	21 lek/m2
B	**TOTALI**		
	PARKIM	***Nj.Bilisht***	***Nj.e Tjera***
1.	I hapur	21 lek/m2	0
2.	I mbyllur dhe bodrume	49 lek/m2	0
C	**TOTALI**		
	TOTALI (A+B+C)		

Detyrimi për pagesë i taksës mbi ndërtesën është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës më sipër.

1. ***Struktura përgjegjëse për vjeljen e takses:*** Detyrimi për familjarët e Njësisë Administrative Bilisht si dhe për fshatrat e çdo Njësie Administrative të cilat furnizohen me ujë të pijshme nga Ujësjellës SH.A, shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Ujësjellësi Korcë në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin agjenti përfiton 2 % të shumës së arketuar. Ndërsa tek fshatrat e Njësive

Administrative të cilat nuk janë të mbuluar nga furnizimi me ujë të pijshëm nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha,taksat familjare do të mblidhen nga punonjësi I taksave në njësinë përkatëse duke shkuar në cdo familje. Deri në përfundimin e hedhjes të të dhënave për sipërfaqet e banimit në sistemin e ngritur nga kadastra fiskale detyrimi vjetor i taksës së ndërtesës për një pjesë të vogël të familjeve të cilat nuk janë evidentuar sipërfaqet e ndërtesave , llogaritet për një sipërfaqe mesatare prej 100 m^2 për ndërtesat e ndërtuara përgjatë dhe pas vitit 93 si dhe me një sipërfaqe prej 70 m^2 për ndërtesat e ndërtuara para vitit 93.Nga e ardhura faktike e rakorduar nga dega e thesarit për periudhen Janar –Nentor dhe duke llogaritur periudhën e mbetur gjithashtu duke marë parasysh edhe rreth 20% e ardhur e munguar për vitin 2024 konkludojmë që e ardhura e pritshme për këtë zë për takse ndërtese për familje të jetë në shumën e përcaktuar në tabelë.

Detyrimi për taksën e ndërtesës për kategoritë Biznese duhet të paguhet brënda datës 30.06.2025. Theksojmë se për shumicën dërmuese të subjekteve sipërfaqja është llogaritur në bazë të dokumentacionit dhe për një numër të kufizuar është marë në konsideratë vetëdeklarimi.
Për ndërtesat njësi shërbimi të cilat nuk ushtrojnë aktivitet do tarifohen 21 lek/m^2.

Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

Në pikën 5 të nenit 21 Rregulla të përbashkëta të taksës për pasurinë e paluajtshme të Ligj Nr. 9632, date 30.10.2006 i ndryshuar parashikohet se, Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për.

a) Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;

d) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale; dh) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

e) Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";

ë) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;

g) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

gj) personat të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar.

h) Taksapaguesin pasuria e të cilit është demtuar nga veprimi I forcave madhore. Në këtë rast lehtësimi ose përjashtimi është I përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 %.

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(Ndryshuar me ligj nr. 10146 datë28.9.2009, botuar ne Fl.Z. Nr. 144, datë 12.10.2009).

Ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, datë 03.12.2018, botuar në F.Z. nr.187, dt.27.12.2018

Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore

Ligji Nr 9632/2006 parashikohet se një pronë që shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa" VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 1. Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi

pronësore, që duhet të taksohet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 2. Vlera e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", referuar verifikimeve në terren Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore. Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 2.1 Sipërfaqja e prezumuar Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë: a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim; b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar. Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 3 3. Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky reduktim është deri në 30 (tridhjetë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Nivelet e miratuara sipas zonave/nënzonave të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore i bëhen të ditura zyrtarisht edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 4. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit. Në rast kur ndërtesa përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore, të parashikuara për t'u përdorur për qëllime të ndryshme apo për t'u tjetërsuar në pronësi të më shumë se një pronari/përdoruesi, si bazë e taksës do të shërbejë kostoja e plotë e ndërtimit të të gjitha njësive përbërëse të ndërtesës, pavarësisht fazës në të cilën gjendet e gjithë ndërtesa e papërfunduar. Në qoftë se njësitë e ndërtesës, bazuar në lejen e miratuar të ndërtimit, janë parashikuar për qëllime të ndryshme përdorimi (për shembull, disa për banim dhe disa për veprimtari ekonomike/joekonomike), vlera e pasurisë së paluajtshme për përcaktimin e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës së përcaktuar me ligj, sipas llojit të përdorimit, shumëzuar me koston e ndërtimit për njësi të ndërtesës. Në rast se zhvilluesit kanë lidhur kontratë shitjeje për tjetërsimin e pronësisë së ndërtesës së papërfunduar apo të njësive të veçanta të saj, si bazë e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, për efekt të llogaritjes së taksës së ndërtesës, do të shërbejnë kontratat e shitjes. Në qoftë se nga krahasimi rezulton se vlera e kontratave të shitjes është e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmimin vlerësues, atëherë si bazë e taksës përcaktohet vlera më e lartë. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me kostot e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në të gjitha rastet e përmendura në pikën 4 të këtij neni, personi që ka për detyrim pagesën e taksës së llogaritur është zhvilluesi. Në rastin kur njësi të veçanta të ndërtesës janë vënë në përdorim dhe taksa paguhet e plotë, paguesi i taksës së llogaritur është përdoruesi.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 5. Llogaritja e shumës së taksës së ndërtesës/ njësisë pronësore Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë: a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim; b) 0,2%, për

ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike; c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 6. Procedura e mbledhjes së informacionit nga verifikimi në terren 6.1 Verifikimi në terren për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme bëhet, në çdo rast, me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet ndërtesa/njësia pronësore që do të vlerësohet. Urdhri i verifikimit përmban: **a)** të dhënat identifikuese për ndërtesën/njësinë pronësore (adresën, njësinë administrative, vendndodhjen, pronarin/përdoruesin etj.) dhe taksapaguesin (emrin e individit, personin fizik, personin juridik); **b)** qëllimin e kryerjes së procesit të vlerësimit të ndërtesës/njësisë pronësore; **c)** kohën kur do të kryhet verifikimi dhe afatin e mundshëm për procesin e verifikimit; **ç)** emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetë-qeverisjes vendore, që do të kryejnë verifi-kimin; **d)** datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore do të paraqiten për të kryer verifikimin. Në qoftë se procesi i verifikimit kërkon plotësimin e formularëve përkatës, këta formularë i dërgohen paraprakisht personit të taksueshëm, së bashku me kopjen e urdhrit për verifikim. Urdhri për njoftimin e kryerjes së procesit të verifikimit dërgohet me postë ose dorazi, kundrejt firmës së personit të taksueshëm, që e ka marrë në dorëzim. Në rast të dërgimit me rrugë postare, konsiderohet se urdhri është marrë në dorëzim pas 10 (dhjetë) ditëve të dorëzimit të tij në zyrën postare. **6.2** Paraprakisht, në njoftimin për kryerjen e verifikimit, taksapaguesi duhet të njihet me objektin e procedurës së verifikimit në vend, arsyet për të cilat kërkohet të kryhet ky verifikim, të drejtat e taksapaguesit për të shprehur mendimet, vërejtjet apo kundërshtitë lidhur me procesin e verifikimit të kryer nga punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore në përfundim të këtij procesi, si dhe të informohet se, në rast moskryerjeje të këtij procesi, njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtën të bëjë vlerësimin me metoda alternative dhe të përcaktojë shumën e taksës vjetore për t'u paguar mbi bazën e këtij vlerësimi**. 6.3** Në rast të mosgjendjes së personit të taksueshëm në ditën dhe orën e caktuar për kryerjen e procesit të verifikimit, njësia e vetëqeverisjes vendore bën njoftim të dytë dhe, nëse përsëritet e njëjta situatë, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësimin, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në këtë metodologji. **6.4** Në rastin e verifikimit në terren, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të hartojnë aktin e verifikimit, si dhe të shënojnë datën e përfundimit të procesit të verifikimit, emrin, mbiemrin bashkë me firmën në fund të aktit të plotësuar prej tyre. **6.5** Punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të informojnë taksapaguesin mbi rezultatin e verifikimit, duke e lexuar me zë të qartë dhe në prani të tij përmbajtjen e materialit të shkruar në aktin e verifikimit dhe, në përfundim, të kërkojnë edhe kundërfirmën prej taksapaguesit, për sa përmban akti i verifikimit. Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë shënimet e veta përkatëse, nëse dëshiron, lidhur me përmbajtjen e aktit të verifikimit, vërejtjet apo kundërshtitë që ka. Gjithashtu, taksapaguesi, krahas emrit, mbiemrit dhe firmës, vendos dhe datën kur ai ka bërë nënshkrimin e tij. **6.6** Kur taksapaguesi pengon punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore të ushtrojnë detyrën e tyre, sipas urdhrit të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore

për këtë qëllim, ndaj tyre do të llogaritet taksa e plotë. Në këtë rast, sipërfaqet do të vlerësohen duke përdorur metodat alternative të vlerësimit, siç përcaktohet në këtë metodologji. **6.7** Në rastet kur nga verifikimi në terren konstatohen ndërtesa/njësi pronësore për të cilat nuk ka informacion paraprak të plotë ose të pjesshëm, atëherë punonjësi i njësisë së vetë-qeverisjes vendore, me anë të një procesverbali, merr masa për plotësimin e të dhënave identi-fikuese, si më poshtë: **a)** Adresën, koordinatat e vendndodhjes gjeo-grafike, sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore; **b)** Qëllimin e përdorimit të ndërtesës/njësisë pronësore; **c)** Të dhënat identifikuese të siguruara për taksapaguesin; **ç)** Emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore që kanë bërë verifikimin; **d)** Datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore kanë bërë verifikimin; **dh)** Çdo informacion tjetër të nevojshëm, që shërben për identifikimin e ndërtesës/njësisë pronësore, taksapaguesin dhe përcaktimin e bazës së taksueshme. Në këtë rast, taksapaguesi duhet të njoftohet për detyrimin e taksës së llogaritur. **6.8** Afati kohor i hedhjes së të dhënave të siguruara nga verifikimi në terren në sistemin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme nuk duhet të jetë më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e mbajtjes së aktit të verifikimit. Në çdo rast të ndryshimit të të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave, qoftë nga verifikimi në terren, qoftë dhe si rezultat i korrektimit apo i vendimit të strukturës vendore të apelimit apo pas një vendimi të formës së prerë të marrë nga Gjykata Administrative, hedhja e të dhënave nuk duhet të jetë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit. **6.9** Hedhja e të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave nuk duhet të dëmtojë funksionalitetin e sistemit. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, nëse konstaton se hedhja e të dhënave mund të dëmtojë sistemin, ndërhyn dhe realizon hedhjen e të dhënave në sistem.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 7. Verifikimi periodik në terren i pasurive të paluajtshme "ndërtesa" Njësia e vetëqeverisjes vendore gëzon të drejtën të bëjë çdo vit verifikime në terren deri në 20 (njëzet) për qind të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast, procesi i verifikimit shërben për verifikimin e ndryshimeve të mundshme në ndërtesat/njësitë pronësore ekzistuese, të cilat ndikojnë në ndryshimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar. Të tilla ndryshime lidhen me zgjerim të sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore, shtesat në kate, përmirësime strukturore, tjetërsim të pronësisë, ndryshim të përdorimit dhe që kërkon ndryshimin e shkallës së taksës, përjashtimin nga taksa apo të humbjes së të drejtës së përjashtimit nga taksa etj. Gjithashtu, ky proces shërben dhe për identifikimin e ndërtesave/njësive pronësore të reja, të pahedhura në sistem. Në rast të verifikimit të ndërtesave/njësive pronësore që nuk rezultojnë në sistemin qendror të të dhënave, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të realizojë regjistrimin e plotë të tyre, duke plotësuar të gjitha elementet e informacionit të kërkuar nga sistemi. Në të gjitha rastet e mësipërme, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bëjë me dije subjektin taksapagues për detyrimin e lindur.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 8 .Verifikimi i të dhënave nga ana e nëpunësit përgjegjës në bashki për taksën e pasurisë së paluajtshme ndërtesë Nëpunësi përgjegjës, për taksën mbi ndërtesën në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ka të drejtën dhe detyrimin të bëjë rishikimin dhe verifikimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të verifikimit në terren, të aktit të verifikimit të mbajtur, si dhe të konfirmojë saktësinë e tyre. Në rast se dokumentacioni përmban

gabime, mangësi apo pasaktësi, ai u kërkon punonjësve, që kanë plotësuar dokumentacionin, rishikimin e tij, si dhe, nëse është e nevojshme, përsëritjen e procedurës së verifikimit.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 9.Korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale dhe çmimet përkatëse Taksapaguesi, në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi, është jo i saktë, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit. Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës: **a)** në zyrën tatimore vendore të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme "ndërtesë", të shoqëruar dhe me dokumentacionin justifikues; ose **b)** në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korrigjimit ofrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me punonjësit e saj. E drejta ose jo e korrigjimit të vlerës përfundim-tare të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" do të përcaktohet pas shqyrtimit të ankimimit nga struktura e autorizuar pranë njësisë së vetëqeve-risjes vendore dhe marrjes së një vendimi për-fundimtar. Zyra tatimore vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit në lidhje me marrjen ose jo në konsideratë të saj, bën korrigjimin, nëse vlerësimi fillestar ka pasur gabime dhe i kthen përgjigje me shkrim taksapaguesit.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 10. Ankimimi administrativ dhe ankimimi gjyqësor Nëse edhe pas marrjes së përgjigjes në lidhje me të drejtën e korrigjimit, taksapaguesi nuk bie dakord me qëndrimin e zyrës tatimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ai ka të drejtë që, bazuar në nenin 7, "Ankimimi", të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, t'i drejtohet strukturës vendore të apelimit tatimor të ngritur për këtë qëllim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Struktura vendore e apelimit tatimor jep qëndrimin e saj brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin tatimor. Nëse taksapaguesi përsëri nuk bie dakord me vendimin e dhënë nga struktura vendore e apelimit tatimor, i drejtohet Gjykatës Administrative. Vendimi i Gjykatës Administrative konsiderohet përfundimtar dhe do të shërbejë për korrektimin e vlerës së bazës së taksueshme, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi. Lindja e detyrimit për taksën e pasurisë ndërtesë/njësi pronësore pas konstatimit të ndryshimeve nga verifikimi në terren Në rastet kur nga verifikimet në terren rezulton ndryshim në vlerën e bazës së taksës, shuma e taksës së llogaritur reflektohet në shumën e taksës për t'u paguar, nisur nga dita e konstatimit në terren të mbajtur në aktin e verifikimit përkatës. Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

VKM Nr 132/2018 neni 2 pika 12. Ndryshimi i përdorimit të ndërtesës nga sa është regjistruar në sistemin e bazës së të dhënave Në qoftë se njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë ndryshime të përdorimit të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore apo pjesë të njësisë pronësore, të cilat sjellin, për pasojë, edhe ndryshimin e vlerës së bazës së taksës, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi, shuma e taksës për t'u paguar, pas ndryshimit të konstatuar për pjesën e mbetur të vitit, korrigjohet dhe mbledhja e taksës bëhet për shumën faktike të taksës së korrigjuar. Ndryshimet për detyrimin për t'u paguar fillojnë nga data

e konstatimit të mbajtur në aktin e verifikimit. Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

VKM Nr 132/2018 neni 3. Nënkategorizimi i ndërtesave/njësi pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, bashkëngjitur këtij vendimi. Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

1. Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;

2. Garazhet e mbyllura;

3. Bodrumet;

4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

VKM Nr 132/2018 neni 4 . Burimet e informacionit (të dhënat parësore) Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë:

a) Të dhënat e vetëdeklaruara nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi/ përdorim të tij;

b) Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;

c) Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;

ç) Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;

d) Të dhënat e ALUIZNI-t për ndërtesat në proces legalizimi;

dh) Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

e) Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;

ë) Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtese, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;

f) Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP

Në aneksin 1 të VKM Nr 132/2018 parashikohet respektivisht se **b)** Cmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr 115/2014,Për ndarjen administrative-teritoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë reduktohet deri në 35(tridhjetë e pesë) përqind krahasuar me cmimin e zones më të afert dhe c) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr 7652 datë 23.12.1992 Për privatizimin e banesave shtetërore të ndryshuar cmimi për meter katror është 70 (shtatëdhjetë) përqind e cmimit sipas zonave të tabelës vetëm në rastin e shitjes së pare.

Në aneksin 2 të VKM Nr 132/2018 parashikohen cmimet mesatare referuese për meter katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimi.

➢ **Taksa mbi tokën bujqësore**

Tokë Bujqësore është toka e përcaktuar si e tillë në rregjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurive. ***Baza e takses:*** Eshtë sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin nr 1 që I bashkëlidhet këtij ligji.

Për cdo kategori minimale të tokës bujqësore këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si mëposhtë: **Tabela Nr 9**

lek/hektar/vit

Nr.	KATEGORITE E TOKES	Niveli I Taksës
		Lek/ha
1.	Kategoria e I	3640 lek/ha
2.	Kategoria e II	2730lek/ha
3.	Kategoria e III	1820 lek/ha
4.	Kategoria e IV	1755 lek/ha
5.	Kategoria e V	1625 lek/ha
6.	Kategoria e VI	1560 lek/ha
7.	Kategoria e VII-X	1400 lek/ha
	TOTALI	

Detyrimi për taksën bujqësore llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave,Lejave , Licensave dhe Borxhit dhe për të gjitha familjet për të cilat ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë nga ndërrmarja e ujësjellësit kjo taksë vilet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin agjenti përfiton 2% të shumës së arkëtuar. Ndërsa për fshatrat në të cilët nuk ofrohet shërbimi apo faturimi i ujit nga ndërmarje e ujësjellësit kjo taksë si dhe taksat familjare do të mblidhen nga punonjësit e taksave në njësinë përkatëse duke shkuar në cdo familje. Referimi mbi të ardhurat e pritshme për këtë taksë është bërë bazuar në informacionin e sjellë Drejtoria e Bujqësisë me shkresë Nr 3047/5 datë 25.09.2025 nga ky informacion rezulton se në teritorin e Bashkisë Devoll bazuar në ligjin 7501 është ndarë 12 836 ha tokë bujqësore.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Për të gjitha kategorite është sektori i të ardhurave në Bashkinë Devoll. Ngarkohet sektori i AMT-ve pranë Bashkisë Devoll për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave duke pasqyruar dhe ndryshimet e herë pas herëshme dhe ia përcjell këte informacion Drejtorisë së të Ardhurave për llogaritjen e detyrimit. Duke parë me kujdes tabelën vemë re që nga taksa e tokës bujqësore sigurohet një e ardhur mjaft e madhe, e cila tregon dhe

orientimin bujqësor që ka bashkia jonë. Theksojmë që për vitin 2026 nuk ka asnjë ndryshim në nivelin e kësaj taksë në krahasim me vitin 2025.

➢ Taksa mbi truallin

Truall është një sipërfaqe toke jo bujqësore që ndodhet brënda vijës kufizuese të ndërtimit e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e takses: Eshtë sipërfaqja e truallit në meter katror në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.Në pikën 1 të nenit 23/1 Taksa mbi truallin të Ligjit Nr 9632/2006. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojne atë.Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë pëdoruesi I truallit bën vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim,pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2 që I bashkëlidhet këtij ligji. Për cdo kategori minimale të truallit këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.Në nenin 25 Pronat që shtrihen në teritorin e më shumëse një njësie të qeverisjes vendore,të Ligj Nr. 9632, date 30.10.2006 i ndryshuar parashikohen përcaktime lidhur me pronat që shtrihen në teritorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore. Përcaktimi I cmimit vlerësues dhe I sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore rregullohet në pikën 1 të nenit 2 të VKM Nr 132/2018

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet në tabelën mëposhtë. **Tabela Nr 10**

lek/m2/vit

Nr.	Kategorite e tokes	Niveli i Takses	
		Nj.Bilisht	***Nj.e Tjera***
1.	Taksa e truallit për banim për familjet	0.28 lek/m^2	0.28 lek/m^2
2.	Taksa e truallit për qëllime biznesi	15 lek/m^2	15 lek/m^2
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të siperfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit mësipër. Informacioni mbi sipërfaqet e truallit për biznesin është siguruar nga të dhënat në dosjet që ndodhen për biznesin tek Drejtoria e të ardhurave. Për shumicën dërmuese të subjekteve ekziston dokumentacion për sipërfaqen e

truallit dhe vetëm për një pjese të vogël është marë në konsideratë vetë deklarimi. Detyrimi për taksën e truallit për shumicën e familjeve paguhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin agjenti përfiton 2 % të shumës së arketuar. Ndërsa për fshatrat në njësitë administrative për të cilat nuk ofrohet furnizimi me ujë nga ndërmarja e ujësjellës kanalizimeve taksat familjare do të mblidhen nga punonjesit e taksave në njësinë përkatëse duke shkuar në cdo familje.

Sipërfaqet e truallit bazohet në certefikatat e pronësisë ku specifikohen metrat katrore , ndërsa për familjet të cilat nuk paraqesin ose nuk zotërojnë certefikatën e pronësisë të siperfaqes së truallit detyrimi vjetor i referencës i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe mesatare prej 300 m^2. Bazuar në statistikat e mara nga gjëndje civile rezulton se në Bashkinë Devoll jane **13,863 familje**. Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit dhe paguhet pranë cdo bankë të nivelit të dytë sipas taksave vendore të biznesit brënda datës 30.06.2026.

Niveli i taksës së truallit nuk ka ndryshim për vitin 2026 krahasuar me vitin 2025.

3. Taksa e fjetjes në hotel

1- Me "hotel" kuptohet cdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel,motel,stabiliment turistik pension shtëpi pritje,turizëm familjar si dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

2- Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri I netëve të qëndruara në hotel.

3- Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim I nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për netë qendrimi me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

4- Subjektet janë të detyruara të bejne vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqeruar me dokumentacionin justifikues për muajin paraardhës.

Strukturat Hoteliere në zonën tonë janë të paktë në numër dhe nuk janë të liçensuara për këtë aktivitet por biznese të ndryshme e ofrojnë si shërbim ekstra. Zona jonë nuk është një zonë me tipare të theksuara turistike gjë e cila do të ritë numrin dhe cilësinë e shërbimit në hotele. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person dhe niveli i taksës së fjetjes në hotel dhe parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë paraqitet në tabelën mëposhtë:

Taksa e fjetjes në hotel **Tabela Nr 11**

Nr.	**Emertimi i Takses**	**Niveli i Takses**	
		Nj.Bilisht	***Nj.e Tjera***
1.	Taksa e fjetjes në hotel 4-5 yje	105	105
2.	Taksa e fjetjes në hotel	35 lek/nate	35 lek/nate
	TOTALI		

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehoet në hotel e cila përfshihet në çmimin e fjetjes dhe mbi të dhe vlera e taksës dhe si rrjedhojë subjektet e hotelerisë kryejne rolin e agjentit pa asnjë përfitim kundrejt saj. Niveli i taksës së fjetjes në hotel nuk ka ndryshim për vitin 2026 krahasuar me vitin 2025.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Inspektoriati Tatimor dhe Kundravajtjeve Administrative.

4. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është siperfaqja e ndërtimit,pronësia e të cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme Tabela Nr 12

Nr	Kategorite e ndërtesave	Niveli i Takses
1.	Ndërtesa banimi	100 lek/m2
2.	Ndërtesa të tjera për tregeti dhe shërbime	300 lek/m2
3.	Ndërtesa të tjera	200 lek/m2
	TOTALI	

Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit në perputhje me aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë.

***Mënyra e mbledhjes: Struktura e ngarkuar për vjeljen të kesaj takse është* Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,e cila në rolin e agjentit tatimor përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e depoziton për llogari përkatës të buxhetit të Bashkisë Devoll jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.**

Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë për të bërë rakordimet e të ardhurave nga kjo taksë. Duke bërë një analizë të tabelës së mësipërme shohim se kemi parashikuar një vlerë mesatare për të tre kategoritë e ndërtesave .Referimi për planifikim është bërë mbi rakordimet e të ardhurave që janë realizuar për këtë zë përgjatë vitit 2025.

Përjashtimet:

Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore e qëndrore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

d) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

e) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Kjo taksë zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisjen me lejë ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera në lekë e cmimit të shitjes për m^2 të investimit të ri. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe të gjitha tarifat e tjera, paguhen para dorëzimit të dokumentit të lejës së ndërtimit. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si ndërtim i ri përcaktohet në perputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejës së ndertimit në tabelën më poshtë. Përcaktimi i vlerave u bë sipas rakordimit me Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresë Nr.3046/1 Prot,datë 20/10/2025.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture **Tabela Nr 13**

Nr.	Kategorite e ndertimeve dhe investimeve	Niveli i Takses	
		Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozimi në %
1.	Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.	4-8 % të cmimit te shitjes për m^2	4% të cmimit te shitjes për m^2

2.	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike. Të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë nga individi apo me sipërmarrës;	1-3% të vlerës së investimit	3% të vlerës së investimit te meret vlera me e madhe midis preventivit dhe cmimit per meter katror ndertimi sipas vkm perkatese
3.	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e bujqësisë.	1% të vlerës të investimit	1 % te vleres se investimit te meret vlera me e madhe midis preventivit dhe cmimit per meter katror ndertimi sipas vkm perkatese
4.	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturën në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infrastruktures se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventive.	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infrastruktures se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventiv.
5.	Ndertimet e reja te cilat jane ne process legalizimi	-0.5%te vleres se investimit per objektin e pare -Objekti I dyte legalizimi me % sipas takses se ndikimit ne infrastructure,nga ndertimet e rej sipas pikes 1 ,2 dhe 3	-0.5%te vleres se investimit per objektin e pare -Objekti I dyte legalizimi me % sipas takses se ndikimit ne infrastrukture,nga ndertimet e rej sipas pikes 1, 2 dhe 3.
6.	Per rikostruksionin e objekteve ekzistuese ,taksa e shqyertimit te ketyre kerkesave te jete ne % sipas pikes 1,2 dhe 3 te vleres se preventivit		
7.	Per ndertesat qe destinohen per qellime banimi ne zonat malore,takse e ndikimit ne infrastrukture 1% e vleres se investimit, Keshilli Bashkiak percakton me vendim Zona Malore per efekt te zbatimit te kesaj takse		
8	Tarifë për depozitimin e inerteve	Cmimi për m^2 100	Cmimi për m^2 100
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

Baza e taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit. Detyrimi për taksën i takon investitorit.
Përjashtime nga Taksa e Ndikimit në Infrastukturë:

- Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.
- Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese Hotel/Resort me 5 Yje , status special, sipas percaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbartës të një marke tregetare të njohur ndërkombëtarisht.
- Investimet e subjekteve të cilat zhvillojnë veprimtarinë pritëse të certefikuar si agroturizëm ,sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizimit .
- Investimet për rindertimin , riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore , sipas përkufizimit të ligjit në fuqi për mbrojtjen Civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentët që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura e ngarkuar për dhënien leje ndërtimi është Drejtoria e Planifikimit të zhvillimit të Territorit. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja dhe tarifave është Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të Territorit.Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastructure nga ndërtimet e reja është Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të Territorit. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen e vlerës së taksës të ndikimit në infrastrukture nga legalizimet është Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të Territorit. Struktura e ngarkuar për njoftimin dhe vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukture nga legalizimet është Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit.

6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të përdorura

Baza e taksës në këtë rast është lloji i mjetit i cili i nënshtrohet këtij detyrimi. Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e depozitojnë, brënda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qëndrore dhe njësive të qeverisjes vendore.

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të përdorura **Tabela Nr 14**

Nr	Emërtimi i Taksës	Niveli i Takses
1.	Taksa e regjistrimit të përvitshëm te mjeteve të përdorura	25% *(ardhura-5%)
	TOTALI	

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është **Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Korcë**, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të

detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore dhe të ardhurave të gjeneruara nga kjo taksë tetëmbëdhjetë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Devoll, pasi (DRSHTRR) të ketë mbajtur 5% si agjent tatimor. Parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë për vitin 2026 e kemi bërë në bazë të vjeljes së kësaj taksë për vitin 2025 të dërguara nga DRSHTRR me shkresë Nr 7695/1 Prot datë 01/10/2025.

7. Taksa e reklamës dhe tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore por jo vetëm të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapesira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose jo dhe që shërbejnë për qëllime idetifikimi. Vendosja e tabelës për qëllime indetifikimi është detyrim për të gjithë subjektet,me perjashtim të ambulantëve. **Drejtoria e Isnpektimit ,Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit** harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi,të thjeshta dhe elektronike.

Kategoritë dhe llojet e tabelave,nivelin e taksës e paraqesim në tabelën mëposhtë:
Tabela Nr 15

Lloji tabelës	Njësia	Bashkia
Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brënda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti I biznesit).		
Deri në 2m²	lekë/m²/vit	0
Mbi 2m² deri 10m²		
- **E thjeshte (pa ndriçim)**	lekë/m²/vit	7 000
- **Me ndriçim të thjeshtë**	lekë/m²/vit	11 500
- **elektronike**	lekë/m²/vit	15 000
Mbi 10 m² deri 20m²		
- **E thjeshtë (pa ndriçim)**	lekë/m²/vit	5 950
- **Me ndriçim të thjeshtë**	lekë/m²/vit	9 775
- **elektronike**	lekë/m²/vit	12 750
Mbi 20 m² deri 40m²		
- **E thjeshtë (pa ndriçim)**	lekë/m²/vit	3 850
- **Me ndriçim të thjeshtë**	lekë/m²/vit	6 325
- **elektronike**	lekë/m²/vit	8 250
Mbi 40m²		
- **E thjeshtë (pa ndriçim)**	lekë/m²/vit	2 800

	- **Me ndriçim të thjeshtë**	lekë/m^2/vit	4 600
	- **elektronike**	lekë/m^2/vit	6 000
Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën e përmasat e tabelave për orientim.			
		lekë/m^2/vit	120
Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme deri ne tavanin maksimal 35 m^2			
	- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m^2/vit	13 500
	- elektronike	lekë/m^2/vit	27 000
Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj			
	- **të të gjitha përmasave**	lekë/m^2/ditë	1 000
TOTAL			

Detyrimi i pagesës për subjektet ekzistuese paguhet brënda datës 30 Qershor të vitit fiskal. Për subjektet që hapen pas datës 30 Qershor shlyerja e detyrimit për taksën e tabelës bëhet deri në 30 ditë nga data e regjistrimit në Q.K.R.Për subjektet e reja detyrimi do të llogaritet nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR. Niveli i taksave nuk ka ndryshim krahasuar me vitin 2025 si rrjedhoje dhe të ardhurat e parashikuara janë në të njëjtat shifra

-Në rastin e më shumë se një tabele,pavaresisht nga vëndodhja,vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë për qëllime indetifikuese, ndërsa tjetra do të konsiderohet si tabelë për qëllime reklamuese. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Devoll.

Për kategorinë e 2 dhe të 3, Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marjes lejë për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e siperfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyre periodike Drejtorinë e të ardhurave në lidhje me të gjitha ndryshimet në siperfaqe dhe në numër të tabelave që janë objekt taksimi. Duke parë dhe analizuar të dhënat e tabelës kemi berë një parashikim të ardhurash të konsiderueshëm nga taksa e tabelës dhe e reklamës të ndara në kategori dhe nënkategori sipas ligjit në fuqi. Planifikimi është bërë mbi të ardhurat e rakorduara për këtë zë duke marë parasysh dhe një ritje të mundshme si pasojë e ritjes së numrit të bizneseve .

8.Tarifa për dhënien e licensave për tregëtimin me pakicë të karburanteve

Dhënia e liçencave për tregetimin me pakice të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikantë dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët

fundorë bëhet nga organet e qeverisjes vendore sipas juridiksionit përkates në rastet kur këto veprimtari do të ndërtohen në territorin e tyre. Pagesa për dhënien për dhënien dhe ripërtëritjen e licensave për stacionet e shitjes të karburanteve,gazit të lengshëm,të naftës për automjetet dhe vajra lubrifikante është 1 000 000 (një million) lekë për licensa me afat pesëvjecar. Për licensa të dhëna me afat me pak se 5 vjet pagesa do jetë një vit kalendarik. Nga kontrollet e kryera nga punonjësit e intitucionit konstatuam se përgjatë vitit 2026 mbarojnë afatet e lejës për tregëtimin me pakicë të karburanteve për 4 subjekte që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë dhe për arsye likuiditeti kryejnë pagesat vjetore duke nënshkruar një marveshje midis Bashkisë Devoll dhe vetë Subjektit. Për vitin 2026 kemi 4 subjekte që I mbaron leja e shitjes me pakicë të karburanteve të cilat I paguajnë me vlerë 1.000.000 me afat 5 vjecar sipas Ligj Nr. 9632, date 30.10.2006 i ndryshuar dhe Ligji 8652 datë 31.07.2000 për organizimin e organeve të qeverisjes vendore,Ligji 8450 datë 24.02.1999 për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre i ndryshuar,VKM nr 170 datë 25.04.2002 për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregëtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të tyre. Struktura për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria e të Ardhurave Lejave licensave dhe Borxhit.

Më poshtë **Tabela Nr 16**

	AUTORIZIM	**Niveli i tarifës**	
1.	Leje per shitjen me pakice te karburanteve	200,000	2 subjekte
2	Leje per shitjen me pakice te karburanteve	1.000.000	2 subjekte
	TOTALI		

10.Te ardhura nga renta minerare **Tabela Nr 17**

	TE ARDHURA NGA TE TRETE	**Niveli i taksës**	
		Nj.Bilisht	**Nj.e Tjera**
1.	Të ardhura nga renta minerare		
2.	Të ardhura nga palë të treta		
	TOTALI		

Në bazë të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, neni 4 pika 4 :
Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguruar nga shitja e mineralit të paperpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore përkatëse. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në castin kur ai shet produkte minerare. Pesë përqind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.
Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Pagesa e rentës minerare bëhet brënda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve

minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brënda vëndit.

TARIFA VENDORE

1. TARIFA E PASTRIMIT

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridike, vëndas ose të huaj që banojnë ose janë rezident dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brënda territorit të Bashkisë Devoll dhe njësive të saj administrative. Nivelet e tarifës se pastrimit dhe kategorite, nënkategoritë dhe nivelet treguese të taksës së pastrimit janë të shprehura në tabelën mëposhte:

Tarifa e pastrimit

/leke **Tabela Nr 18**

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë që paguajnë tarifen e pastrimit	Niveli i Tarifës	
1	**FAMILJET**	***Nj.Bilisht***	***Nj.e Tjera***
	1.a Tarifa për Familje	3,000 lek/vit	3,000 lek/vit
	TOTALI (1)		
2	**INSTITUCIONE**	**Lek/vit**	
	2.a Ujësjellësi	150,000	
	2.c Filiali I Elektrikut OSHEE	150,000	
	2.d Filiali i Postës Shqiptare SHA	40,000	
	2.e Spitali	100,000	
	2.f Drejtoria e Shëndetit Publik	30,000	
	2.g Qëndra Shëndetësore	30,000	
	2.h Institucionet e tjera	15,000	
	2.i Dogana		300,000
	TOTALI (2)		
3	**BIZNES I VOGEL**		
	3.a Byrektore,Mëngjezore.	13,000	13,000
	3.b Tregeti Bulmet,Mish,Peshk,fruta perime, ushqimore	15,000	15,000
	3.c Profesjon i lire avokat, noter, arkitekt, inxhinjer,ekspert kontabel.	13,000	13,000
	3.ç Farmaci	20,000	15,000
	3.d Restorant,	30,000	30,000
	3.e Fast Food	20,000	15,000
	3.f Tregeti artikuj industriale,Kancelari	13,000	13,000

	3.g Sherbime,transport,	10,000	10,000
	3.gj klinika dentare	10,000	10,000
	3.i Bare-Kafene,Lokale Nate	17,000	17,000
	3.j,Servis,Gomisteri,	20,000	20,000
	3.k Lavazhe	15,000	15,000
	3.l Bilardo.	10,000	10,000
	3.ll Pike llotarie	25,000	25,000
	3.m Prodhimi ,Perpunim bulmeti e te ngjashme	25,000	25,000
	3.n Pike karburanti	25.000	20.000
	3.o Prodhimi ,Perpunim druri,betoni etj te ngjashme	20,000	20,000
	3.p Furre Buke ; Mulli bloje e te ngjashme	20,000	15,000
	TOTALI (3)		
4	**BIZNES I MADH MBI 14 MILION LEKE**		
	4.a Subjekte tregeti import eksport material ndertimi e te ngjashme .	60,000	60,000
	4.b Subjekte tregeti import eksport industrial, produkte bujqesore	50,000	50,000
	4.c Subjekte tregeti import eksport produkte ushqimore	40,000	40,000
	4.ç Subjekte Transporti kombetar e nderkombetar.	25,000	25,000
	4.d Firma Ndertimi	130,000	130,000
	4.e Njesi Prodhimi,	55,000	55,000
	4.f Karburant ; Farmaci	55,000	20,000
	4.f Njesi Prodhim mbi 100 punonjes	100,000	100,000
	4.g Njesi Prodhim mbi 200 punonjes	2000,000	200,000
	4.gj,Supermakete	100,000	100,000
	4.i ,Banka	65,000	65,000
	4.j Pika lloto	65,000	65,000
	4.k Fondacione,kompani sigurimesh, sherbime	30,000	30,000
	4.l Miniera,Gurore etj te se njejtes natyre	150,000	150,000
	4.m TAP AEG ALBANIA		300.000
	4.m Subjekte Prodhim energjie, etj te se njejtes natyre	250,000	250,000
	TOTALI		
5	**AUTOMJETET**		
	5.a Shoqeri Transport (Autobuza)	50,000	50,000
	5.b Autobuza	25,000	25,000
	5.b Mikrobuza	20,000	20,000
	5.c Furgona	10,000	10,000

	5.d Vetura	7,000	7,000
	TOTALI		
6	**AMBULANTE**		
	6.a Tregeti Ambulante	7,000	7,000
	TOTALI)		
	TOTALI (1+2+3+4+5+6)		

Detyrimi për pagesën e tarifës së pastrimit është vjetor.

Për të gjitha familjet për të cilat ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë dhe faturimit të tij nga ndërmarja e ujësjellësit kjo tarifë do të pasqyrohet në faturën e ujit e ndarë në këste mujore.Likujdimi i kësaj pagesë do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për familjet për të cilat nuk ka faturim të ujit nga ndërmarja e ujësjellësit kjo tarifë do të mblidhet nga Inspektoriati Tatimor, kundravatjeve, Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit me anë të inspektorëve të këtij Sektori .

Shënim: Për fshatrat; Vidohovë, Nikolicë, Gjyres, Vërnik dhe Grapsh Tarifa e Pastrimit për Familje do të jetë 600 lek/vit për arsye të ndodhjes në terene të largëta dhe malore deri në marrjen e sherbimit të duhur.

- Për kategorinë e 2 pagesa e detyrimit do të bëhet Brënda vitit fiskal.
- Për kategorinë e 3,4 dhe 5 detyrimi paguhet Brënda datës 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për cdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korent i regjistrimit pranë QKR.
- Për të gjitha kategoritë nëse subjekti taksa pagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korent për të cilën është bërë kërkesa) dhe duke pjestuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal. ***Struktura përgjëgjese për vjeljen e tarifës*** është Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit e cila bën mbledhjen e saj duke u bazuar në përllogaritjen e kostos së mbetjeve sipas VKM Nr.319 datë 31.05.2018 nga Agjensia e Shërbimeve në Bashkinë Devoll ,për familjaret e njësive administrative strukturë përgjegjëse është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha Ujësjellësi është agjenti tatimor dhe perfiton 2 % të shumës së arkëtuar nga kjo tarifë ,duke bërë një analizë të gjërë të parashikimit të të ardhurave nga kjo tarifë shohim se kemi një të ardhur të konsiderueshme në buxhetin e bashkisë për vitin 2026.

Një peshë mjaft të madhe në këtë tarifë zë kategoria e tarifës së pastrimit për familjarët por dhe ajo për tarifën e pastrimit për bizneset. Parashikimi i të ardhurave është bërë duke pasur si referencë të ardhurat faktike nga çdo kategori,kostos së mbulimit të pastrimit vjetor, numri i familjeve të mara nga gjëndja civile , por dhe numrit të bizneseve të regjistruar të marë evidencë nga organet kompetente. Shpresojmë që dhe shërbimin e pastrimit për të gjitha kategorite mësipër të jetë në nivele shumë të mira që të justifikojë tarifën e paguar nga cdo kategori. Drejtoria e të ardhurave do të jetë "avokati mbrojtës" i cdo kategorie të përmëndur në tabelën mësipër n.q.s shërbimi i pastrimit nuk do të kryhet në nivelin e duhur nga njësia përkatëse, duke evidentuar një gjë të tillë do të jetë

sektori përkatës që mbulon pastrimin për mosvjeljen e detyrimit. Theksojmë se për kategorinë familjare niveli i kësaj tarife për vitin 2026 do të jetë i unifikuar në të gjithë teritorin e bashkisë. Kjo tarifë është parashikuar në të njëjtin nivel me vitin 2025.

2. TARIFE NDRICIMI

Tarifa e ndricimit paguhet nga bizneset vëndas ose të huaj, personat fizikë ose juridik, familjet vëndase ose të huaj që banojnë ose janë rezidentë Brënda teritorit të Bashkisë Devoll. Kategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së ndricimit janë të shprehura si mëposhtë:

Tarifa e Ndricimit **Tabela Nr 19**

Nr.	Kategoritë e T.Ndricimit	Niveli i Tarifes	
		Nj.Bilisht	***Nj.e Tjera***
1.	Tarifë ndricimi për Familjet	1 800 lek/vit	1.800 lek/vit
2.	Tarifë ndricimi Biznes I vogël	5 000 lek/vit	5 000 lek/vit
3.	Tarifë ndricimi Biznesi madh	10.000 lek/vit	10.000 lek/vit
4	Tarifë ndricimi (parqe fotovoltaike eolike,hece)	50.000 lek/vit	50.000 lek/vit
5.	Tarifë për institucione shtetërore	10.000 lek/vit	10.000 lek/vit
	TOTALI		
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

- Për kategorinë e parë detyrimi do të mblidhet nëpërmjet faturës së ujit e ndarë në 12 muaj. Ky detyrim do të jetë në faturën e konsumit të ujit të pijshëm. Likujdimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Ndërsa për familjet për të cilat nuk ofrohet faturimi i ujit nga ujësjellisi kjo tarifë do të mblidhet nga Inspektoriati Tatimor nëpërmjet Inspektorëve që ka në dispozicion.
- Për kategorinë e 2 dhe 3 detyrimi paguhet Brënda datës 30 Qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për cdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korent i regjistrimit pranë QKR.
- Për kategorinë 4 detyrimi paguhet brënda Vitit Fiskal.

Për të gjitha kategoritë nëse subjekti taksa pagues pushon veprimtarinë gjatë vitit detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korent për të cilën është bërë kërkesa) dhe duke pjestuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës së ndricimit : për familjet që ndodhen brënda teritorit të Nj.A Bilisht dhe për fshatrat e Njësive Administrative të tjera të cilat furnizohen me ujë nga **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha**, ky i fundit është përgjegjës për mbledhjen e kësaj tarife së bashku me Drejtorinë e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit, pasi Ujësjellësi është agjenti tatimor dhe përfiton 2 % të shumës së arkëtuar nga kjo tarifë. Ndërsa për kategorinë e dytë të tretë dhe të katërt përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e saj është Drejtoria e të Ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për cdo kategori është marë si referencë numri faktik i familjeve që rezultojne në qytetin e Bilishtit dhe për njësitë administrative dhe bizneseve të regjistruar që rezultojne 120 biznese të mëdha dhe rreth 340 biznese të vogla. Shpresojmë dhe urojme që të kemi një mbulim sa më të gjërë,efikas dhe cilesor të ndricimit publik në të gjithë teritorin që mbulon Bashkia Devoll, për ti ofruar cdo qytetari një shërbim sa më cilësor për cdo tarife që paguan.

3. TARIFE GJELBERIMI

Tarifa e gjelbërimit paguhet nga çdo familje e cila është e regjistruar me gjëndje civile në territorin e njësisë Administrative Bilisht sipas shkresës datë 15.10.2025 të Zyrës të Gjendjes Civile Devoll, numri i familjeve në qytet është 3679 nga të cilat 320 familje janë të përjashtuar nga tarifa e gjelbërimit. Për njësitë e tjera Administrative nuk është aplikuar tarifa e gjelbërimit, të dhënat dhe niveli i tarifës paraqitet në tabelën mëposhtë:

Tabela Nr 20

Nr	Kategorite e T.Gjelberimit	Niveli i Tarifes	
		Nj.Bilisht	**Nj.e Tjera**
1.	Tarifa e gjelbërimit për Familje	480 lek/vit	
2.	Tarife e gjelbërimit Biznes i Vogel brënda territorit te Qyteti i Bilishtit	3.000 Lek/vit	
3.	Tarife e gjelbërimit Biznes i Madh brënda territorit të Qyteti të Bilishtit	5.000 lek/vit	
4.	Tarife e gjelbërimit Biznes i Madh parqe fotovoltaike	50.000	50.000
5.	Tarifë gjelberim për institucione shtetërore	5.000 lek/vit	
	TOTALI		
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

Për pagesën e detyrimit për njësinë Administrative Bilisht tarifa paguhet në këste, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të jetë në faturën e konsumit të ujit të pijshëm. Likujdimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Detyrimi për tarifën e gjelbërimit është vjetor. Për kategoritë e dytë e të tretë dhe të katërt Tarifa paguhet brënda datës 30 qershor të vitit 2026.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së gjelberimit është Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha pasi pagesa e kësaj tarife do të mblidhet duke paguar njëkohesisht në faturën e ujësjellësit në rolin e agjentit tatimor. Vlera e parashikuar e të ardhurave nga kjo tarifë është bazuar mbi një mesatare të familjeve të regjistruara dhe familjeve që jetojnë në qytet dhe në faktik të bizneseve dhe institucioneve shtetërore në Qytetin e Bilishtit.

Përsa I përket kategorisë cdo **familje rezidente efektive** detyrimi vjetor do të shpërndahet për peridhën Janar 2026- Dhjetor 2026 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve pranë Sporteleve të Ujësjellës kanalizme Devoll,sporteleve të Postës Shiqptare SHA dhe sporteleve të Bankave.

Përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore familjare (pastrim, ndricim, gjelbërim, mirmbajtje varezash) për vitin 2026 të gjitha familjet jo efektive të cilat nuk disponojnë me dokument pasuri të paluajtshme nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës dhe nuk gjenden në

banesë dhe nuk banojnë në adresën e deklaruar (vërtetuar me dokument pronësie dhe pashaportën e kryefamijlarit ose vërtetim nga sistemi TIMS që vërteton kohën e qëndrimit në një shtet tjetër).

4 . Tarifa për Mirëmbatjen e Rrugëve Rurale

Tabela Nr 21

Nr	Kategorite e T.Mirëmbatjen e Rrugëve Rurale	Niveli i Tarifes	
		Nj.Bilisht	**Nj.e Tjera**
1.	Tarifa për Mirëmbatjen e Rrugëve Rurale Familjarët	1 200 lek/vit	1 200 lek/vit
2.	Tarifa për Mirëmbatjen e Rrugëve Rurale Biznes I Madh	5 000 lek/vit	5 000 lek/vit
3.	Tarifa për Mirëmbatjen e Rrugëve Rurale Biznes I Vogel	2 000 lek/vit	2 000 lek/vit
	TOTALI		
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

5. Tarifa e zënies së hapësirave publike

Baza e tarifës për zënien e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj.

Kategorite e tregëtimit në hapësirat publike që ve në dispozicion Bashkia Devoll dhe niveli i taksës paraqitet në tabelën mëposhtë.

Taksa e zënies së hapësirave publike
lek/m2/ditë

Tabela Nr 22

Nr.	Kategoritë e tregëtimit	Niveli i Taksës	
		Njësia bilisht	**Nj.tjera**
1	Tregëti fruta-perime	50 lek/m2	30 lek/m2
2	Tregëti mish dhe peshk	50 lek/m2	30 lek/m2
3	Tregëti industrial	50 lek/m2	30lek/m2
4	Zënia e hapësirës publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit,me vendosje platformash,rethim me vazo lulesh etj.. Për të gjithë vitin	10 lek/m2 ne dite	
5	Reklamim malli të subjekteve në hapësira publike	50lek/m2/dite	
6	Tarifa për linjat ajrore	2600lek/km/vit	
7	Tarifa për linjat nëntokësore	1300lek/km/vit	
	TOTALI		
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

Struktura për dhënie leje për zënien e Hapësirës Publike është **Drejtoria Inspektimit dhe Kontrollit te Territorit** përllogaritja dhe vjelja e kësaj tarife bëhet nga **Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë e Devollit**, nëpërmjet **Inspektoriatit Tatimor, kundravatjeve, Administrative,**

Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit i cili bën llogaritjen e detyrimit sipas bazës së taksës së zenies së hapësirave publike dhe bën derdhjen e saj për llogari të bashkisë.**Inspektoriati Tatimor së bashku me Policine Bashkiake dhe Inspektoriatin e kontrollit të Territorit** janë të ngarkuar për përllogarijen e gjobave dhe penaliteteve në rast të një subjekti I cili nuk është i pajisur me këtë leje . Planifikimi i të ardhurave për vitin 2026 është bërë bazuar në një mesatare të sipërfaqes së zënë të hapësirës publike që tregëtohet në territorin e Bashkisë si dhe nga fakti i vitit 2025, informacione të mara nga zyra e kontrollit dhe zhvillimit të territorit së bashku me Inspektoriatin Tatimor. Të ardhurat me të mëdha janë llogaritur dhe mblidhen ditën e Diel pasi dhe në këtë dite zhvillohet tregu në qytetin e Bilishtit ndërsa në njësinë administrative Miras zhvillohet ky treg ditën e Premte por në përmasa shumë here më të vogla.

6. TARIFAT PER LEJAT DHE CERTIFIKATAT E TRANSPORTIT

Tarifa e pagesave për Licenca, Çertifikata për Transport Rrugor, aplikohen sipas pasqyres të miratuar me shkresën e Ministrise te Financave Nr. 13786/1 datë 27/01/2010.Tarifat e aplikuara janë të njëjta me të një viti para. Struktura përgjegjëse në Bashki për dhënien e licencave dhe certifikatave të transportit është përgjegjëse për llogaritjen dhe mbledhjen e kësaj tarife nga personat që i ofrohet ky shërbim.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Drejtoria përgjegjëse për vjeljen e tarifës është ajo e të Ardhurave dhe Licensimit si dhe për dhënin e licencave dhe certifikatave të transportit, më pas kjo zyrë do të mbajë rakordimet përkatëse për vjeljen e kësaj tarife.

Tabela Nr 23

1.	**Tarife per Licencat**			
	1.a Taksi (4+1)	5.000 lek/vit		
	1.b Taksi (6+1)	5.000 lek/vit		
	1.c Taksi (8+1)	10.000 lek/vit		
	1.d Transport për vetë max 3.5ton	2.000 lek/vit		
	1.e Transport për të tretë mbi 3.5ton	5.000 lek/vit		
	1.f Transport për të tretë	5.000 lek/vit		
	1.g Licencë trasporti ndërkombëtar me autobus	40.000 lek/vit		
	TOTALI (1)			
2.	**CERTIFIKATE TRANSPORTI**			
	2.a Taksi (4+1)	2.000 lek/vit		
	2.b Taksi (6+1)	2.000 lek/vit		
	2.c Taksi (8+1)	5.000 lek/vit		
	2.d Transport udhëtarësh specifik për llogari të vet	5.000 lek/vit		
	2.e Autorizim i përkohshëm	1.000 lek/muaj		
	2.f Libër udhëtimi për shërbimet e rastit	3.000 lek/liber		
	TOTALI (2)			
	TOTALI (1+2)			

Parashikimi i të ardhurave për këtë tarife është bërë mbi të ardhurat e realizuara për vitet 2023-2025 dhe numrin faktik të licencave dhe certifikatave të lëshuara përgjatë vitit 2025 .

7. TARIFE LEJE (NON STOP)

Tarifë "leje non stop" është tarifë e cila do të paguhet nga subjektet të cilët do të ushtrojnë veprimtarine e tyre ekonomike mbas orës 23.00 dhe që do të pajisen me lejën përkatëse për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari. Leja non stop do tu jepet atyre subjekteve të cilët me parë kanë bërë kërkesë ku e cila te jetë e shoqeruar me firmat e ¾ te banorëve të komunitetit të zonës përreth.Hapësira e zonës përreth dhe komuniteti i saj do të vleresohen nga inspektorët e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nga inspektorët e Inspektoriatit Tatimor, kundravatjeve, Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit .

Struktura e ngarkuar për dhënien e "lejes non stop" është **Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit** Të dhënat mbi bazën e tarifës dhe kategoritë përkatëse për pajisjen me këtë leje paraqiten në tabelën mëposhtë së bashku me parashikimin e të ardhurave nga kjo tarifë.

Tarifa "leje non stop"

Tabela Nr 24

Nr	Kategorite e T."leje non-stop"	Niveli i Tarifes		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	*Nj.e Tjera*	*Nj.Bilisht*	*Nj.e Tjera*
1.	Karburante,restorante dasmash bar etj..	15.000	15.000		
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)				

Parashikimi i të ardhurave është bërë mbi aktivitetet ekzistuese dhe që ushtrojnë aktivitet pas orës 23.00 dhe nga rakordimet e viteve 2024-2025.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës: është Drejtoria e Inspektimit të Territorit në Bashkisë Devoll dhe Inspektoriati Tatimor, kundravatjeve, Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit.

8. TARIFE PARKIMI

Tarifën e parkimit e paguan cdo person që ka mjet të licensuar për të kryer aktivitet të transportit të udhëtarëve .

Baza e tarifës dhe kategoritë që i detyrohen kësaj tarife paraqiten në tabelën mëposhtë:

Tarifa e Parkimit **Tabela Nr 25**

Nr	Kategorite e T.Parkimit	Niveli i Tarifes	
		Nj.Bilisht	*Nj.e Tjera*
1.	Taksi (4+1)	7.000 lek/vit/mjet	

2.	Taksi (6+1)	7.000 lek/vit/mjet	
3.	Taksi (8+1)	10.000 lek/vit/mjet	
4.	Autobusa	20.000 lek/vit/mjet	
5.	Mjete transporti udhëtarësh nga Bashkitë e tjera	30.000 lek/vit/mjet	
6.	Tarife vjetore per parkim te rezervuar per subjekte fizike dhe juridike	15.000 lek/mjet/vit	
	TOTALI		
	TOTALI		

Tarifa e parkimit paguhet në momentin e pajisjes me leje ose certifikate transporti nga zyra për dhënien dhe pajisjen me licenca dhe certifikata transporti si dhe në cdo përseritje viti kalendarik të saj nqs kjo leje është e dhënë për më shumë se 1 vit. Parashikimi i të ardhurave nga kjo tarifë është bërë me të njëjtën referencë të tarifës së parashikuar për lejat dhe certifikatat e transportit,numri i mjeteve që do e paguajne këtë tarifë është përllogaritur njëlloj.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së parkimit është zyra që do të pajise me leje dhe certifikate transporti përsonat e interesuar,pagesa do të kryhet në momentin e marjes së lejes ose certifikates së transportit nga organet kopetente në Bashkinë e Devollit. Kjo tarifë do të paguhet për cdo mjet njëherë në vit dhe referuar tarifës së mësipërme pagesa ditore është rreth 55 lek/ditë për cdo autobus për parkim.

Struktura e ngarkuar për miratimin e lejës për vendparkim të rezervuar është **Drejtoria e Inspektimit dhe mbrojtjes së Teritorit**. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Mbledhjes të Borxhit në Bashkinë Devoll. Struktura e ngarkuar për penalitete për mos paisje me lejë për vendparkim të rezervuar,mosrespektim të kushteve të lejës është Drejtoria e Inspektimit dhe Mbrojtjes së Teritorit,Policia Bashkiake.

9. TARIFE SHERBIM VARRIMI

Për njësinë administrative Bilisht tarifa e shërbimit të varimit aplikohet për cdo vdekje pasi të gjithë bazën materiale dhe shërbimin ofrohet nga Bashkia, ndërsa për katër njësitë e tjera për vitin 2026 do të jetë në vlerën e shënuar me poshtë dhe mirëmbajtja e tyre do të bëhet nga punonjësit e Agjensisë të shërbimeve Utilitare Komunitare dhe Administrative të Bashkisë Devoll.

Tarife Shërbim Varrimi **Tabela Nr 26**

Kategorite e Tarifes se Varrimit	Niveli i Tarifes	
	Nj.Bilisht	*Nj.e Tjera*
Tarifë Shërbim varrimi	15.000 lek/varim	5.000
Tarifë Shërbim Zhvarimi	20.000 lek/zhvarimi	10.000
TOTALI		
TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)		

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës është Drejtoria e të Ardhurave Lejeve Licensave dhe Borxhit. Pagesa e detyrimit për njësinë administrative Bilisht do të kryhet në momentin e kryerjes së çregjistrimit të personit të vdekur nga familjarët e tij në zyrën e gjëndjes civile.

10. TARIFË PËR MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE

Tabela Nr 27

	Për të gjitha familjet në Territorin e Bashkisë Devoll	**600 lekë në vit**
	Total	

Për pagesën e detyrimit tarifa paguhet në këste,për cdo muaj për cdo familje. Ky detyrim do të jetë në faturën e konsumit të ujit të pijshëm.Likujdimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së gjelbërimit është Drejtoria e të Ardhurave në bashkepunim me Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha pasi pagesa e kësaj tarifë do të mblidhet duke paguar njëkohësisht në faturën e ujësjellësit në rolin e agjentit tatimor. Vlera e parashikuar e të ardhurave nga kjo tarifë është bazuar mbi një mesatare të familjeve të regjistruara dhe familjeve që jetojnë.

11. TARIFA TE NDRYSHME BASHKIE

Tarifa të ndryshme bashkie përfshin tarifën për shërbime të ndryshme që i ofrohet qytetareve nga Bashkia. Kjo tarifë përfshin dhe aplikime të ndryshme nga cdo qytetar në bashki për shërbim apo dokument të ofruar nga Bashkia.

Tarifat e ndryshme dhe niveli i tyre paraqiten në tabelën mëposhtë:

Tarifa të ndryshme bashkie

Tabela Nr 28

Nr.	Kategoritë dhe llojet e tarifave	Niveli i Tari	fes
1.	Tarifë vërtetimi	100 lek	
	Tarifë vërtetim punonjës/familjar	100 lek	
2.	Tarifë vërtetimi nga arshiva	500 lek	
2.a	Tarifë vërtetim nga IVMT	1 000 lek	
3.	**3.a**Tarifë aplikimi për leje ndërtimi **3.b**Tarifë për leje prishje ndërtimi **3.c** Tarifë për shtyrje afati për leje ndërtimi	5 000 lek 2 000 lek 2 000 lek	
4.	Tarifë për leje zhvillimore	2.000 lek	
4.a	Tarifë për punime që nuk pajisen me leje ndërtimi	2.000 lek	
5.	Tarifë për leje përdorimi	20 lek/m2	
6.	Tarifë aplikimi për deklarate paraprake punimesh	2.000 lek	
7.	Tarifë aplikimi për ndryshim funksioni	2.000 lek	
8.	Tarifë për ndryshim subjekti dhe zhvilluese	2.000 lek	
9.	Leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimeve	2.000 lek	
10.	Tarifë për njoftim fillim punimesh	1.000 lek	
	Tarifë për autorizim për ushtrim aktiviteti nga subjekte që kanë seli në Bashki të tjera	5.000 lek	
12.	Tarifa nga zjarrfiksja	Sipas vkm	
	TOTALI		
	TOTALI		

Baza e tarifës është e ndryshme në varësi të tarifës për të cilën paguan. Në tabelën mësipër paraqiten një sërë tarifash të cilat aplikohen nga zyra të ndryshme në Bashkinë Devoll.
Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifave të ndryshme të bashkisë të paraqitura në tabelën mësipër janë cdo zyre që do i ofrojë shërbimin përkatës qytetarit kundrejt pagesës së tarifës. Parashikimi i

të ardhurave nga ky zë është llogaritur mbi një mesatare të faktit të të ardhurave nga cdo zë për vitin 2025 dhe viteve më parë.

12. TARIFE PER QERA TRUALLI

Tarifa e qerasë së truallit parashikohet në bazë të kontratave që kemi me marrëveshje mes dy palëve, nga ana e Bashkisë dhe qeramarrësit si dhe nga ana e ish komunave tani njesi administrative dhe qeramarsit. Tarifat janë të percaktuara në ligjin përkates që i pergjigjet lindjes së këtij detyrimi. Në tabelën mëposhtë pasqyrohen të gjithë kompanitë të cilat i detyrohen Bashkisë Devoll për tarifën e qera trualli sipas kontratës së lidhur midis palëve,sipas metrave katror të marra në shfrytëzim . Për kontratat qera trualli me vlerë të lartë Bashkia Devoll ka nënshkruar Akt-Marveshje për likujdimin me këste të qerasë.

Tarifë për Qera Trualli

***Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës**:* është **Drejtoria e të Ardhurave Lejave, Licensave dhe Borxhit**, **Drejtoria e Pyjeve në Bashkisë Devoll**, **Drejtoria e Sherbimeve Juridike,Prokurimeve dhe Zbatimit të Kontratave në bashkëpunim midis të gjithë sektorëve.**

13. TARIFE CERDHE

Në njësinë administrative Bilisht kemi çerdhen e fëmijëve. Tarifa e çerdhes është pagesa mujore për çdo fëmije që do të regjistrohet në çerdhe. Me pagesën e tarifës së çerdhes nga cdo familje që për fëmijën e saj mer shërbimin në çerdhe ku perfshihet mëngjesi dhe dreka për fëmijët,bazuar Urdher i Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale Nr.76/1 datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të Çerdheve dhe Kopshteve" dhe Urdhër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 457 datë 13.06.2018 "Për një ndryshim të urdhërit Nr 76/1 datë 24.01.2018 "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të Çerdheve dhe Kopshteve"Sipas rakordimit të kryer me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale,Shëndetësore dhe Strehimit në tabelën mëposhtë paraqitet tarifa e çerdhes për fëmijë në muaj. Ligj nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Ligj nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

Tarifa e cerdhes **Tabela Nr 30**

Nr	**Tarifa**	**Niveli i Tarifës**		**E Ardhura e Parashikuar (lek)**	
		Nj.Bilisht	***Nj.e Tjera***	***Nj.Bilisht***	***Nj.e Tjera***
1.	Tarifë mujore për fëmijë	4.000 lek/muaj	0		0
	TOTALI				**0**
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)				

Parashikimi i të ardhurave për këtë zë është bërë bazuar në shkresë me Nr 3071/1 datë 07.10.2025. nga Drejtoria e Arsimit Kulturës,Rinisë dhe Sportit mbi një numër mesatar të fëmijëve të regjistruar në cerdhe. Për vitin 2026 është bërë një parashikim mesatar prej 30 fëmijë në muaj me vlerë 1.248.000 lek. Pagesa e tarifës kryhet cdo muaj nga prindërit që regjistrojnë fëmijet në çerdhe. Pagesa ditore për një fëmijë është 180 lek dita sipas tarifës mujore 4000 lek : 22 ditë = 180 lek dita. ***Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj tarife*** është çerdhja e qytetit, përgjegjësja e saj bën mbledhjen e tarifës për cdo fëmijë dhe i depoziton të ardhurat për llogari të Bashkisë në Arka e Institucionit .

14. KAMATVONESA DHE NIVELET E GJOBAVE TE BASHKISE DEVOLL

Llojet dhe nivelet e gjobave që do të aplikohen nga punonjësit e Bashkisë sipas llojit të shkeljes administrative dhe secili sektor përgjigjet për shkeljen administrative të bërë nga çdo banor rezident ose jo rezident në territorin e Bashkisë Devoll do të paraqiten në tabelën mëposhtë.

Llojet dhe nivelet e gjobave dhe kamatvonesave.

Tabela Nr 31

	Niveli i Tarifes
1.a Kamatvonesa për mos shlyerje të detyrimeve të prapambetura tatimore (taksa, tarifa vendore),	Per cdo dite vonese 0.06% e vleres se detyrimit total te papaguar (maksimumi 22%/vit)
1.b Mospajisja me NIPT për ushtrim aktiviteti të ndryshëm Biznesi.	10.000 lek
2.a Dëmtim, carje rruge	50.000-100.000 leke
2.b Dëmtim, carje trotuari	100.000 leke
2.c Bllokim rruge dhe trotuari	50.000 leke
2.d Nxjerja e inreteve plehut të bagëtive dhe mbetjeve që ndotin ambjentin në territorin publik nga familjarë	5 000 leke
2.e Dëmtim i shtyllave të ndricimit dhe i ndricuesve	100.000 leke
2.f Ndërhyrje dhe dëmtim I rrjetit të ndricimit publik	100.000 leke
2.g Nxjerja e inerteve dhe e mbetjeve që ndotin ambjentin nga subjekte fizike dhe juridike	50 000 lek
3.a Dëmtim I hapesirave publike të gjelbërta	50.000 leke
3.b Dëmtim, prerje pemësh	100.000 leke
3c Vendosje tabelash,pankartash, banderolash pa leje	10.000 leke
3.d Të gjitha shkeljet dhe kundravajtjet e tjera administrative që nuk janë të parashikuar mësipër	5.000 lek
TOTALI	

Shënim: Të gjitha penalitetet e mësipërme nuk kanë fuqi prapavepruese.

Kamatvonesa për mosshlyerje në afat të detyrimeve tatimore aplikohen vetem për subjektet e tatueshëm (që janë të pajisur me NIPT). Përllogaritja e kamatevonesës kryhet nga Inspektoriati Tatimor i kundravatjeve, Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit .

Subjektet të cilat konstatohen që ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me Nipt në momentin e kontrollit nga ana e Inspektoriatit Tatimor, Kundravatjeve, Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit krahas gjobës që mund ti vendoset si shkelje e ligjeve në fuqi gjithashtu do i faturohen detyrime sipas paketës fiskale që në momentin e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit nga sektori përkatës, ku një kopje e këtij procesverbali do i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Korcë për veprime të mëtejshme.

- Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjen administrative*".
- Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.
- Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Devoll.

Për të gjitha pagesat për taksa dhe tarifa vendore që do të bëhen nga subjektet për detyrime të prapambetura do të mbahet kamatvonese në nivelet e percaktuara në tabelë. Detyrime të prapambetura do të jenë të gjitha detyrimet që ka subjekti përjashtuar ato të vitit korent.

Strukturat e ngarkuara për arkëtimin e gjobave dhe penaliteteteve për mos pajisje me leje të ndryshme dhe për veprimet e tjera kundravjatese janë Policia Bashkiake, Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriati Tatimor, kundravatjeve,

Administrative, Debitorëve, Konfiskimit dhe Sekuestrimit, në rast mospagese me dëshirë nga ana e personave apo subjekteve që kanë marrë gjobat dhe penalitetet së bashku me Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha do ngarkohet në faturën e ujit të personit ose Administratorit të subjektit .

1. 15. XIII. TARIFA VJETORE E MIRËMBAJTJES KANALE KULLUES DHE RRUGEVE BUJQESORE

Përsa i përket tarifave për ujitjen gjenden në tabelën më poshtë,dhe parashikimi i të ardhurave është bërë nga Sektori përkatës i ujitjes dhe kullimit. Drejtoria e Bujqësisë me specialistët e saj kryen veprimet për evidentimin e subjekteve dhe familjeve që marrin këtë shërbim të Ardhurat për këtë tarifë do të mblidhen nga punonjësit përkatës sipas grupeve të punës që do të ngrihen me urdher të Kryetarit të Bashkisë Devoll dhe do të arkëtohen në arkën e Bashkisë Devoll. **Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës është Drejtoria e Bujqësisë.**

Llojet dhe nivelet e tarifave të pyjeve dhe bujqësisë

2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes kanale kullues dhe rrugeve bujqesore

Tabela Nr 32

Kategorite	Njesia	E ardhura e parashikuar
Tarifa vjetore e mirëmbajtjes të kanaleve kullues dhe rrugëve bujqësore për të gjitha Njësitë Administrative .	100 Lekë/Dynm	
Tarifë shërbim kryerje analize toke	500 lek/moster	

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e kësaj tarife është **Drejtoria e Bujqësisë** me specialistët e saj e cila kryen veprimet për evidentimin e subjekteve dhe familjeve që marrin këtë shërbim duke u bazuar në AMTP e ndara për secilën familje . Të Ardhurat për këtë tarifë do të mblidhen me anë të faturës së ujit dhe në fshatrat që nuk mbulohen nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korcë Sha do të mblidhen nga punonjësit përkatës dhe do të arkëtohen në arkën e Bashkisë Devoll. **Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës është Drejtoria e Bujqësisë** në bashkëpunim me **Drejtorinë e të Ardhurave Lejave Licensave dhe Borxhit**.